



## NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë Specialist me Kontratë Pune në pozicionin “**Specialist Programist IT**” për plotësimin e nevojave me punonjës mbështetës për kryerjen e aktivitetit “CENS-it të Popullsisë dhe Banesave 2020”.

### **Termet e referencës dhe kriteret e përzgjedhjes për pozicionin (3) Specialistë Programist IT pranë njësisë së Teknologjisë së Informacionit(TI) për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020**

#### **Misioni**

Krijon, mirëmban programe kompjuterike dhe bazat e të dhënave përkatëse, për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020, për çdo fazë të procesit statistikor.

#### **Qëllimi i pozicionit të punës**

Specialisti programist i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, përgjigjet para Drejtuesit të Njësisë së TI të Censit për zhvillimin, testimin, mirëmbajtjen në kohë të programeve të ndryshme kompjuterike dhe zhvillimin e sistemeve mbështetëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020, si edhe përgjigjet për krijimin e administrimin e bazave të të dhënave përkatëse.

#### **Detyrat Kryesore**

- Zhvillon, teston, mirëmban dhe dokumenton programe për kompjuter për proceset e ndryshme të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020.
- Ndhmon në kontrollin e aplikacioneve të reja përpara së të zbatohen për të përcaktuar lehtësinë e përdorimit dhe për të gjetur problemet e mundëshme.
- Harton programe për të gjeneruar raporte sipas nevojave.
- Krijon dhe mirëmban bazat e të dhënave të aplikacioneve për të cilat është përgjegjës.
- Trajnon stafin e suportit të TI në terren, ndihmon në procesin e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve për mbledhjen e të dhënave.
- U përgjigjet kërkesave të përdoruesve për asistencë. Identifikon burimin e problemit (software ose gabim anketuesi/kontrollori) dhe zgjidh problemin, e referon dhe e diskuton problemin me eprorin.
- Punon në grup, atëhere kur i ngarkohet, për të zhvilluar pjesë të caktuara të një aplikacioni.
- Kryen detyra të tjera që mund t'i ngarkohen.

#### **Kualifikime dhe Eksperienca**

Të ketë përfunduar studimet universitare në Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Informatike, ose fusha të ngjashme.



Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

### Aftësi të tjera

- Të jetë bashkëpunues;
- Të jetë i aftë të punojë në grup;
- Të jetë i aftë të menaxhojë situata të paparashikuara;
- Të ketë aftësi të ndërtojë marrëdhënie efektive të punës me stafin e projektit dhe partnerët;
- Të jetë kreativ dhe fleksibël gjatë performacës së tij;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.

### Fushat e Njohurive

- Njohuritë mbi Ligjin nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar
- Njohuritë mbi Ligjin e Nëpunësit Civil nr. 152/2013.
- Njohuri mbi VKM nr. 303, datë 31.03.2011 "Për krijimin e njësive të Teknologjisë së Informacionit dhe të -Komunikimit në Ministrinë e Linjës dhe Institucionet e varësisë.
- Njohuri mbi sistemet e menaxhimit të bazave të të dhënave;
- Koncepte mbi programimin e orientuar ndaj objekteve: